



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Mujoor –Qershor 2007

Qasja publike në procedurat që përfshijnë, fëmijët viktimë të veprave seksuale penale dhe veprave tjera serioze penale shkel ligjin vendor dhe parimin në interesin më të mirë të fëmijës

OSBE Misioni në Kosovë është e shqetësuar që seancat publike në rastet e viktimave fëmijë¹ në rastet seksuale dhe krime të tjera serioze nuk përputhen me parimet e përgjithshme të interesit më të mirë të fëmijëve dhe shkelin ligjin vendor.

Edhe pse Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive Fundamentale (KNBDLF) parasheh të drejtën individuale për gjykim publik, ajo gjithashtu ofron që kjo e drejtë mund të kufizohet në disa raste, përfshirë këtu “kur interesat e të miturve ashtu e kërkojnë”² Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) gjithashtu kufizon të drejtën për gjykim publik, kur interesi i jetës private i palëve e kërkon”³ Për më tepër, Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) përshkruan që “[në] të gjitha veprimet sa i përket fëmijëve, të ndërmarra nga institucionet për mirëqenie sociale, private apo publike, gjykatat, autoritete administrative apo organet legjislativë, interesi i fëmijës do të jetë interesimi primar”.⁴

Dispozitat e ligjit vendor lidhur me publikun në procedurë ku janë të përfshirë fëmijët viktimë, zënë vend në Ligjin e Kosovës mbi të Miturit (LMM).⁵ Kur janë të kyçur kryesisht e mitur, neni 47 i LMM parasheh përgjithësisht që “[të] gjitha procedurat ku të miturit⁶ janë të përfshirë do të jenë konfidenciale”, Kjo dispozitë gjithashtu aplikohet kur të rriturit raportohen për kryerjen e një veprë ndaj fëmijëve,⁷ si dhunim, ngacmim seksual, rrëmbim, ndërmjetësim në prostitucion dhe trafikim.⁸ Rrjedhimisht, në raste të tilla gjykatësi duhet të mbaj seanca *me kamera* dhe të përjashtojë publikun.⁹

Pavarësisht nga këto kërkesa ligjore, OSBE ka monitoruar disa raste përkitazi me vepra seksuale dhe krime tjera serioze të kryera kundër fëmijëve ku gjykatësi ka lejuar qasje publike në seancë:

¹ Sipas Nenit 2(1) të Ligjit të Kosovës mbi të Miturit (LMM) (Rregullores së UNMIK-ut Nr.2004/8 për Ligjin e Kosovës mbi të Miturit 20 Prill, 2004), termi “fëmijë” donë të thotë personin nën moshën 18 vjeçare.

² Neni 6(1) KDPNj. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), e arsyeton këtë përjashtim në rastet ku përfshihen krimet seksuale kundër fëmijëve (*shih X v Austria*, nr. 1913/63, 30 Prill 1965).

³ Neni 14(1) KNDCP. Neni 6(1) KEDNj përmban dispozita të ngjajshme.

⁴ Neni 3(1), KDF. “Interesi më i mirë i fëmijës” do të ruhet me një numër masash duke përfshirë këtu gjykime të mbyllura, kur është e nevojshme të mbrohet intimiteti i fëmijës (shih Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm 10/2007, paragrafi 23).

⁵ Rregullorja e UNMIK-ut nr.2004// Mbi Ligjin për të Miturit, 20 Prill 2004 (LMM). LMM duhet të shihet si *lex specialis* (ligj i posaçëm) kur krahasohet me KPPPK (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/26, *Mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës*, 6 Korrik 2003), dhe ligjet tjera që mund të aplikohen tek të miturit në procedurë penale. (shih Neni 4, LMM).

⁶ I mitur definohet me Nenin 2(2) të LMM-së si dikush mes moshës 14 dhe 18,

⁷ Shih Neni 143(5), LMM.

⁸ Shih Neni 141, LMM *Racionalja* e kësaj dispozite është që të zvogëlohet “viktimizimi për të dytën herë” i viktimës (shih Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Rekomandimi 2006/8 *Mbi asistencën ndaj viktimave të krimit*, 14 Qershor 2006).

⁹ LMM gjithashtu ofron teknika alternative të marrjes në pyetje kur pala e dëmtuar e mitur dëgjohej si dëshmitarë. Për shembull, fëmija mund të merret në pyetje në shtëpinë e vet apo në Qendrën për Punë Sociale (Neni 143(3), LMM) apo jashtë gjykatës me mjete të televizionit me qark të mbyllur (Neni 143(4), LMM). Për më tepër, ekzaminimi i fëmijës do të bëhet me ndihmën e një pedagogu, psikologu apo ndonjë eksperti tjetër (Neni 143(1) dhe (2), LMM).

Në një rast në Gjykatën e Qarkut në (...) në një rast të pretenduar të tentim () nga (...),¹⁰ kryetari i trupit gjykues lejoi për afërsisht 20 student të fakultetit juridik që të marrin pjesë në seancë gjyqësore për qëllime studimi gjatë seancës së mbajtur me(). Fëmija ishte tepër nervoz, dhe kur është pyetur për incidentin e supozuar ajo nuk ishte në gjendje të dëshmojë lidhur me faktet kyçe vendimtare për përcaktimin e përgjegjësisë penale.

Në një rast tjetër në Gjykatën e Qarkut në (...) ku ishin të përfshirë (...) të pandehur (...) të akuzuar (),¹¹ kryetari i trupit gjykues e shpalli të hapur për publik seancën e(), edhe pse një viktimë e detyruar e prostitucionit ishte një vajzë shtatëmbëdhjetë vjeçare.

Në rastin e tretë në Gjykatën e Qarkut në (...) në një rast të supozuar të () të një vajze pesëmbëdhjetë vjeçare, me () gjykatësi dështoi të nxjerrë një vendim për përjashtimin e publikut dështoj të përjashtoj publikun nga salla e gjyqimit për të konfirmuar aktakuzën kundër (...) të pandehurve.

Në shembujt e shënuar më lartë, gjykatësit dështuan që të përjashtojnë publikun në rastet që përfshijnë fëmijët si viktima të veprave seksuale penale. Kjo shkel ligjin vendor dhe parimin e interesit “në interesin më të mirë të fëmijës”.

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon që:

- Gjykatësit të përjashtojnë publikun nga procedurat që përfshijnë fëmijët si viktima të veprave seksuale penale dhe veprave tjera serioze penale, ashtu siç kërkohet me Ligjin mbi të Miturit.
- Kur është e nevojshme që të merren në pyetje fëmijët si viktima, gjykatësit duhet të përdorin teknika alternative të marrjes në pyetje që ofrohen me Ligjin mbi të Miturit, siç janë marrja në pyetje e fëmijës në shtëpinë e tij/saj, në Qendrën për Punë Sociale apo përmes televizionit me qark të mbyllur.
- Publikut nuk duhet ti jepen informata apo dokumente (p.sh. procesverbalet apo vendimet) në rastet që përfshijnë fëmijët si viktima të veprave seksuale penale dhe veprave tjera serioze penale.

Përkthimi jo adekuat gjatë seancave gjyqësore shkel ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

OSBE është e shqetësuar që përkthimet e dobëta nga gjuha Shqipe komuniteteve jo shqipëtare në seancat e rasteve civile shkelin ligjin vendor dhe gjithashtu standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Parimi i një gjykimi të drejtë, i garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj),¹² përfshinë mundësinë e palës për pjesëmarrje efektive në

¹⁰ Neni 193, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2003/25, *Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës* (KPPK), 6 Korrik 2003.

¹¹ Neni 201(1), KPPK

¹² Neni 6, KEDNj.

procedurat gjyqësore. Në kuptim të parimit të “barazisë së armëve”¹³ dhe lirisë nga diskriminimi”¹⁴, pjesëmarrja e barabartë e palëve në një shtet me disa gjuhë zyrtare përfshin të drejtën për të përdorur në mënyrë të barabartë këtë gjuhë zyrtare të cilën palët janë në gjendje ta kuptojnë dhe të shprehën para gjykatës.¹⁵ Për më tepër Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Minoriteteve (KEGjRM)¹⁶ imponon obligimin e gjykatave civile që “{...} kurdo që një ndërgjyqës duhet të paraqitet personalisht në gjykatë, ai ose ajo mund të përdor gjuhën e tij/saj regjionale apo minoritare pa pësuar shpenzime tjera {...} nëse e nevojshme me përdorimin e interpretuesve dhe përkthimeve.”¹⁷

Në vazhdim KEDNJ, KEGjRM, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë¹⁸ ofrojnë që komunitetet dhe anëtarët e tyre do të kenë të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre lirshëm në Gjykatat e Kosovës.¹⁹ Më hollësisht, Ligji i aplikueshëm mbi Procedurën Kontestimore (LPK) thekson që:

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që gjatë pjesëmarrjes në seancat dhe gjatë ndërmarrjes verbale të veprimeve të tjera procedurale para gjykatës, të përdorin gjuhën e vet. Nëse procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, respektivisht të pjesëmarrësve të tjerë, në procedurë do të sigurohet përkthimi verbal në gjuhën e tyre e gjithë asaj që parashtrohet në seancë, si dhe përkthimi verbal i dokumenteve që përdoren në seancë si prova.²⁰

Për më tepër gjykatat domosdo duhet të informojnë palët dhe pjesëmarrësit për të drejtën e tyre në përkthim.²¹

¹³ Në *De Haes dhe Gijssels v. Belgjikës*, 1983/1992, 24 Shkurt 1997, par. 53, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksoi “që parimi i barazisë së armëve – një komponentë e një koncepti më të gjerë e një gjykimi korrekt - kërkon që secilës palë ti jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij nën kushtet që nuk e vejnë atë një disfavor substancial vis—a – vi kundërshtarit tij.”

¹⁴ Neni 14 KNDNJ,

¹⁵ Sipas Neni 2(1) të Ligjit nr.02/L-37 *Mbi përdorimin e Gjuhëve*, 27 Korrik 2006 e nxjerrë me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2006/51, 20 Tetor 2006 (Ligji mbi Gjuhët) Shqip dhe Serbisht janë gjuhët zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë. Për më tepër gjuhë të tjera mund të kenë statusin e gjuhësjenë zyrtare në nivel komunal nëse një anëtarë i komunitetit që përbën së paku 5% të komunës flet gjuhën amtare (Neni 2(3) i Ligjit mbi Gjuhët).

¹⁶ Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Minoriteteve, e adoptuar nga Këshilli i Evropës me 5 Nëntor 1991 (KEGjRM), direkt e aplikueshme në Kosovë sipas Neni 3(2)(g) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 *Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë*, 15Maj 2001 (Korniza Kushtetuese).

¹⁷ Neni 9(1)(b) KEGjRM. Në Kosovë, KEGjRM aplikohet për të gjithat gjuhët e komuniteteve minoritare (p.sh Turke, Boshnjake, Rome) edhe pse nuk janë gjuhë zyrtare sipas Neni 2 të Ligjit mbi Gjuhët (Neni 1(a) KEGjRM).

¹⁸ Shin fusnotën 14.

¹⁹ Neni 4(4)(a) i Kornizës Kushtetuese.

²⁰ Neni 102(1) Ligji mbi Procedurën Kontestimore (LPK), Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 20/90 dhe 35/91. Gjithashtu edhe Ligji mbi Gjuhët, përfshin përdorimin e gjuhëve zyrtare në procedurat gjyqësore. Sipas Neneve 12-18 të Ligjit mbi Gjuhët, gjuhët zyrtare do të përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore, personat pjesëmarrës në procedurat gjyqësore mund të përdorin njërën nga gjuhët zyrtare sipas zgjedhjes së tyre, dhe gjykatat do të zhvillojnë procedurat në gjuhët zyrtare sipas zgjedhjes së palëve, dhe nëse e nevojshme do të sigurojnë përkthim simultan. LPK nuk kundërshton, por është më specifik se dispozitat e Ligjit mbi Gjuhët. Rrjedhimisht, dispozitat e LPK që kanë të bëjnë me gjuhët ende aplikohen në Kosovë (shih Neni 37 të Ligjit mbi Gjuhët).

²¹ Neni 102(2), LPK. Sipas Neni 105 të LPK, gjykata paguan shpenzimet lidhur me përkthimin.

Megjithatë, OSBE ka monitoruar disa raste ku përkthimi i ofruar nga përkthyesit në procedurat civile ka qenë jo adekuat, duke shkelur ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj²²

Në një rast të paraqitur pranë Gjykatës Komunale në (...) me datë (...) Janar (...) gjatë seancës së parë përkthyesi përktheu vetëm vërejtjet e gjykatësit në gjuhën Serbe, dhe nuk arriti të përkthej deklaratën e përfaqësuesit të paditësit nga gjuha Shqipe në atë Serbe. Në seancën tjetër, përkthyesi përgatiti procesverbalin e seancës në vend se të përkthej gjatë procedurës gojarisht. Në një tjetër seancë përkthyesi lëshoi seancën për të pranuar një thirrje telefonike kështu që nuk pati përkthim.

Në rastin e dytë në Gjykatën Komunale në (...), gjatë seancës së mbajtur me (...) Tetor (...) përkthyesi përktheu vetëm nga gjuha Shqipe në atë Serbe. Si pasojë paditësi Serb nuk ishte në gjendje të ndjek procedurën, nuk mësoj të gjithat çështjet ligjore dhe faktike të diskutuara në seancë dhe nuk ka mundur të intervenojë në mënyrë efektive.

Në një rast në Gjykatë Komunale në (...), gjatë seancës të mbajtur me (...) Korrik (...) përkthyesi nuk përktheu gjatë tërë seancës. Më saktë, përkthyesi përktheu nga gjuha Shqipe në gjuhën Serbe vetëm ato pjesë kur gjykata apo përfaqësuesi bënin pyetje direkt për palën Serbe.

Në rastet e sipër përmendura, Gjykatat nuk ofruan përkthim të plotë fjalë-për-fjalë të procedurave gjyqësore. Palët nuk ishin në gjendje të ndjekin procedurën e plotë dhe kjo ndikoi në të drejtën për një gjykim korrekt. Dështimi i gjykatave për të siguruar përkthim adekuat jo vetëm që shkel ligjin vendor por edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Rrjedhimisht OSBE rekomandon që:

- Gjykatat duhet të informojnë palët për të drejtën e tyre në përkthim të pa ndërprerë fjalë-për-fjalë me ndihmën e përkthyesit në fillim të seancës së parë.
- Gjykatat duhet të punësojnë përkthyes me aftësi të nevojshme²³.
- Gjykatësit duhet të sigurojnë që përkthyesit të përkthejnë gjitha pjesët e procedurës fjalë-për-fjalë dhe dëshmitë janë të përkthyer saktë në gjuhët që palët kuptojnë.

²² Edhe pse shembulli i dytë dhe i tretë janë nga viti 2005 shembulli i parë është nga viti 2007 që tregon vazhdimësinë e problemit të përkthimit jo adekuat në seancat e rasteve civile.

²³ Shih gjithashtu Raportin e OSBE-së *Përkthimi dhe Interpretimi në Sistemin Gjyqësor të Kosovës*, Janar 2007.